



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura III**

---

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 12

Prishtinë, më 22. 10. 2008, ora 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**P r o c e s v e r b a l**  
**i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme**

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Enis Kervan, Eqrem Kryeziu, Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ibrahim Gashi, Ardian Gjini dhe Radmilla Vujoviq.

Munguan: Ramadan Avdiu dhe Nexhat Daci.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit, me këtë

**R E N D I T E**

- 1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e dt. 12.06.2008, 04.09.2008, 17.09.2008, dhe 07.10.2008,**
- 2. Puna e Komisionit,**
- 3. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e dt. 12.06.2008, 04.09.2008, 17.09.2008, dhe 07.10.2008,**

Miratohen procesverbalet nga mbledhjet e dt. 12.06.2008, 04.09.2008, 17.09.2008 dhe 07.10.2008, me vërejtjet e deputetëve Ramë Buja e Xhavit Haliti për mënyrën e hartimit të tyre.

Komisioni vendosi që në ardhmen procesverbalet e Komisionit të mos komentohen, në mënyrë që të ekzistoj dallimi në mes të transkriptimit dhe procesverbalit.

**2. Puna e Komisionit,**

**Sabri Hamiti** lidhur me punën e Komisionit tha se kemi nevojë që të bëjmë konsultime, për një koordinim me Kryesinë dhe kryetarin e Kuvendit rreth veprimtarisë së Komisionit, në përfaqësime dhe komunikime me parlamentet e tjera. Për komunikime me jashtë, njoftoi anëtarët e Komisionit se kemi një letër falënderuese nga z. Miller kryetar i Komisionit për Punë të Jashtme të Këshillit të Zvicrës, për pritjen që i kemi bërë në këtu dhe ka bërë një ftesë për të cilën jam në komunikim të konkretizimit të saj. Në vazhdim ai tha se në komunikim me z.Prenç Zogaj, kryetar i Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Shqipërisë, jam informuar se Komisioni i tyre ka vendosur që ta ftoj Komisioni tonë në një vizitë, por ende nuk ka arritur ftesa. Sa i përket komunikimit, propozoi që Komisioni t'ju dërgoj letër falënderimi komisioneve homologe të shteteve fqinje që kanë njohur Kosovën, Maqedonisë dhe Malit të Zi si dhe të ftohen për vizitë. Lidhur me këtë ide mendon se duhet konsultuar me Kryesinë e Kuvendit, të dërgojmë në shkresën si Komision apo së bashku me Kryesinë e Kuvendit.

**Ardian Gjini** përkrahu idenë që të dërgohet shkresa nga ana e Komisionit dhe shtoi se nëse Komisioni vendos për dërgimin e një shkrese, ajo duhet të nënshkruhet nga ana e kryetarit të Komisionit.

**Ibrahim Gashi** propozon që shkresa falënderuese për këto dy vende, duke e pas parasysh edhe ftesën për vizitë, të bisedohen edhe në Kryesi për arsye koordinimi.

**Sabri Hamiti** konstatoi se, kjo iniciativë përkrahet nga Komisioni por veprimet dhe ftesat duhet të jenë të koordinuara me Kryesinë meqë përveç tjerash kërkojnë edhe buxhet. Lidhur me buxhetin e Kuvendit, për veprimtarinë me parlamentet e tjera, kërkoi të informohet nga z. I.Gashi i cili ka marr pjesë në cilësi të anëtarit të Kryesisë në takimet me Komisionin për Buxhet.

**Ibrahim Gashi** njoftoi deputetët se, në takimin me Komisionin për Buxhet në mes tjerash është shqyrtuar edhe kërkesa për aktivitetet e Kuvendit me kuvendet e tjera, që më parë këto lloj shpenzime janë quajtur shpenzime të udhëtimeve jashtë vendit, ndërsa tani i kemi quajtur shpenzime për nevoja të bashkëpunimit ndërparlamentar të Kuvendit me kuvendet e shteteve të tjera.

Komisioni për Buxhet ka arritur në përfundim që të shikoj mundësinë për rritje të këtij destinimi nga 300 mijë euro që ka qenë në vitin e kaluar, në 850 mijë euro për vitin 2009, për aktivitetet ndërparlamentare të Kryesisë dhe të Komisionit për Punë të Jashtme.

**Xhavit Haliti** lidhur me projektbuxhetin e Kuvendit për këtë vit, mendon se nuk ka asnjë dallim nga buxheti i vitit të kaluar, gjë që për ushtrimin e veprimtarisë së Kuvendit në rrethana tani të reja, buxheti i paraparë do të jetë i pamjaftueshëm .

**Ibrahim Gashi** propozoi që në mbledhjen e ardhshme të Kryesisë së Kuvendit të ftohet edhe kryetari i Komisionit për Buxhet, që të njoftoj se si janë emërtuar shpenzimet buxhetore.

**Lutfi Haziri** mendon se për funksionalizim më të mirë të Komisionit nevojitet një koordinim i punëve me zyrën e Presidentit, Kryeministrit dhe të MPJ si dhe të ketë mjete buxhetore. Sa i përket buxhetit tha se është i pamundur tani ndryshim i shifrave buxhetore sepse ndikon në ndryshimin e skemës buxhetore, por propozoi që të bëhen përpjekje maksimale në këtë drejtim.

**Eqrem Kryeziu** propozoi që të insistohet nga Komisioni që të jenë buxhetet e ndara për pushtetet.

**Sabri Hamiti** kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen se për veprimtarinë ndërparlamentare të Komisionit të kërkohet vijë e veçantë buxhetore, apo të ekzistojë vija buxhetore e përbashkët në Kuvend për këtë veprimtari.

**Ardian Gjini** për të dy variantet buxhetore për veprimtari ndërparlamentare të propozuara tha se kanë anët e tyre pozitive dhe negative. Përkrahë variantin që Komisioni për Punë të Jashtme të ketë vijë të veçantë buxhetore.

**Xhavit Haliti** mendon se çështja e shqyrtimit të buxhetit ndryshe nga tani duhet të jetë e përcaktuar me Rregulloren e Punës së Kuvendit që të jetë objekt diskutimi i të gjitha komisioneve të Kuvendit, e pastaj ato t'i paraqesin propozimet e tyre për shqyrtim në Kuvend.

**Ramë Buja** përkrahë mendimin se buxheti në të ardhmen duhet shqyrtuar nga të gjitha komisionet parlamentare, njëkohësisht përkrahë propozimin që Komisioni për Punë të Jashtme të ketë vijë të veçantë buxhetore për marrëdhënie ndër parlamentare.

**Xhavit Haliti** konsideron se çështja e buxhetit meriton të shqyrtohet, duke e pasur parasysh se Kosova tani është në një fazë të re të pushtetit, është e nevojshme të përcaktohet se çfarë forme buxhetore dëshirojmë.

**Sabri Hamiti** propozoi të kërkohet, që në kuadër të buxhetit të Kuvendit të ndahet një vijë buxhetore për çështje të komunikimit me jashtë dhe të bëhen specifikimet nëse është e nevojshme së bashku me kryetarin e Kuvendit dhe Kryesinë, si dhe të kërkohet që buxheti të jetë i ndarë në bazë të pushteteve.

Komisioni pas këtyre diskutimeve nxori këtë

### **P e r f u n d i m**

Të kërkohet një vijë e veçantë buxhetore për veprimtarinë ndërparlamentare të Komisionit, si dhe buxhetet të jenë të ndara sipas pushteteve.

#### **3. Të ndryshme.**

**Sabri Hamiti** informoi anëtarët e Komisionit se ekziston interesimi që me Komisionin të komunikojë zyra e kthimit në Prishtinë, për çka mendon se në të ardhmen duhet shikuar mënyrat e këtyre komunikimeve. Po ashtu informoi se ka interesime për komunikim në mes të Komisionit dhe përfaqësuesve të zyrës së Quintit.

**Sabri Hamiti** lidhur me vizitat jashtë vendit, njoftoi anëtarët e Komisionit se është parashtruar një kërkesë për pjesëmarrje të deputetëve Lutfi Haziri e Ardian Gjini në sesionin e PER-it, në Selanik me kompensim të mëditjeve nga Kuvendi.

Komisioni lidhur me kërkesën për pjesëmarrje në sesionin e PER-it në Selanik nxori këtë

### **P e r f u n d i m**

T'i rekomandohet Kryesisë së Kuvendit, që të lejojë pjesëmarrjen e deputetëve Lutfi Haziri dhe Ardian Gjini në sesionin e organizuar nga PER-i në Selanik, me kompensim të mëditjeve nga dt. 23-26 tetor 2008 .

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

Kryetari i Komisionit

Sabri Hamiti

Përgatitur nga

Njësia për mbështetje të Komisionit